



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.14/2017

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët, Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Skender Çoçaj, anëtarë të Komisionit, në procedurë disiplinor kundër xxxxx xxxxxx, ish Gjyqtar Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në xxxxxx-Dega në xxxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2017-091, në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/08/2017, për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, Arianit Salihu, dhe gjyqtarit xxxxx xxxxx, më datën 30.08.2017, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Xxxx xxxxxx, ish Gjyqtar Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në xxxxxx-Dega në xxxxxx, është përgjegjës për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2017-091, i njëjti në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/08/2017, të përcaktuar në nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës, sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223).
2. Për shkak të vërtetimit të sjelljes së pahijshme, gjyqtarit xxxx xxxx i shqiptohet masa disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për 25% në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, duke filluar prej muajit në vijim pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurorit Disiplinor ja ka paraqitur raportin përfundimtar me numër ZPD-2017-091, së bashku me shkresat e lëndës Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilin xxxx xxxxx, ish Gjyqtar Mbikëqyrës është i akuzuar për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo

keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223).

Zyra e prokurorit Disiplinor ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare informacionet e pranuar nga një bartës i funksionit gjyqësor lidhur me sjelljet e mundshme të pahijshme të ish Gjyqtarit Mbikëqyrës xxxx xxxxx. Është pretenduar se ish Gjyqtari Mbikëqyrës xxxxxj, si rezultat i neglizhencës në menaxhimin e Degës së Gjykatës në xxxxx, nuk ka vepruar në përputhje me përgjegjësit administrative lidhur me regjistrimin e më shumë se tetë mijë (8000) lëndë të natyrës kundërvajtëse të vitit 2016. Pas zhvillimit të hetimit ZPD pretendon që ka siguruar prova të mjaftueshme mbi bazën e të cilave e ka mbështet këtë raport përfundimtar duke i rekomanduar Komisionit Disiplinor inicimin e procedurës disiplinore dhe në bazë të të gjeturave të shqiptoj një sanksion disiplinor.

Gjatë analizimit të shkresave të lëndës të siguruar gjatë zhvillimit të hetimit disiplinor, ZPD ka gjetur se me datë 09 mars 2017, një komision i përberë nga xxxx xxxxx, Administrator i Gjykatës Themelore në Prishtinë, xxxx xxxx, Udhëheqës i Zyrës për menaxhimin e Lëndëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Përparim Zeka, Bashkëpunëtor Profesional-Projekti i USAID, Gjykata Themelore në Prishtinë, kanë qenë në objektin e degës në xxxxx lidhur me konstatimin e gjendjes për lëndët e pa regjistruara gjatë vitit 2016 nga lëmia e kundërvajtjes. Ky komision ka konstatuar se citoj: “Sipas raporteve statistikore zyrtare të rregullta sistematike që përpunojnë gjykatat në baza mujore dhe vjetore, rezulton se Dega në xxxxxx gjatë vitit 2016, nga lëmia e kundërvajtjes i ka pranuar dhe regjistruar 9761 lëndë, ndërsa sipas përgjegjësve të degës dhe referentit përkatës edhe 8.000 lëndë tjera të kësaj natyre, nuk i kanë regjistruar fare dhe nuk i kanë raportuar si lëndë të pranuar në raportet zyrtare statistikore. Kjo do të thotë se, në këtë degë të gjykatës, gjatë vitit 2016 janë pranuar gjithsejtë 17761 e jo 9761 lëndë siç qëndron në raportet zyrtare statistikore. Sipas gjyqtarit mbikëqyrës dhe ndihmës administratorit të degës, kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së stafit”.

Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur me datë 30.08.2017, gjyqtari xxxxx xxxxx ka deklaruar se raporti i Zyrës së Prokurorit Disiplinor nuk është aspak i bazuar në fakte dhe argumente dhe nuk ka siguruar prova që unë kam kryer sjellje të pa hijshme. Theksoj se nga viti 2013 e këndeje kjo gjykatë është ballafaquar me një varg sfidash, në mungesë të stafit mbështetës të gjyqtarëve. Kjo ka ndodhur me rastin e reformave që ka ndodhur në gjyqësi gjatë vitit 2013. Në këtë periudhë kësaj gjykate i janë marruar pesë (5) punëtor të stafit administrativ, të cilët kryesisht kanë punuar në divizionin e kundërvajtjes, dhe se të njëjtin janë sistemuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, apo në Gjykatën e Apeli. Prej këtij momenti kjo degë e Gjykatës është ballafaquar në vazhdimësi me probleme rreth regjistrimit të lëndëve për shkak të fluksit të madh të lëndëve dhe se ka qenë e pa mundur që të gjitha të regjistrohen. Që nga viti 2013 nuk kanë mundur të regjistrohen asnjëherë të gjitha lëndët, kështu që janë bartur nga viti në vitin tjetër. Thekson se në vitin 2016 nuk kanë mundur të regjistrohen lëndët për shkak të mungesës së stafit, dhe se një pjesë e tyre janë

Faqe2nga5

bartur në vitin 2017 dhe se në pjesën e parë të këtij viti janë regjistruar dhe të gjitha janë dërguar te gjyqtari për kundërvajtje. Lidhur me këtë çështje e ka njoftuar në 2013 edhe kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë z. xxxxxx. Në mënyrë sistematike ka njoftuar edhe drejtorin e sekretariatit të KGJK-së, drejtori e Administratës dhe Personelit të SKGJK-së, ku i ka njoftuar me vështirësitë, problemet me të cilat po ballafaqohet kjo Gjykatë për shkak të numrit të madh të lëndëve, pamundësisë për regjistrimin e tyre dhe mungesës së stafit. Përkundër njoftimit të personave përgjegjës unë asnjëherë nuk kam marrë mbështetje. Të gjitha lëndët që kanë ardhur kah fundi i vitit 2016 janë regjistruar në fillim të vitit 2017 dhe se tani janë përcjellur të gjyqtari i kundërvajtjes dhe se asnjë nuk është e parashkruar. Në raportin e ZPD thuhet që unë jam përgjegjës edhe për mos paraqitjen e lëndëve si të pakryera, nuk qëndron se sipas neni 8 të Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm të Gjykatave, kjo çështje është e definuar si përgjegjësi e administratorit të gjykatës. Raportet statistikore i ka përcjelluar vazhdimisht administratori në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk kam qenë i informuar dhe nuk kam dhënë urdhër që lëndët e pa regjistruara të mos raportohen.

Me kohë i kam njoftuar organet përgjegjëse dhe për shkak të mos mbështetjes nga ana e tyre unë kam paraqitur dorëheqje te kryesuesi i KGJK-së në vitin 2015, të cilën me vonë e kishte tërhequr, ka deklaruar gjyqtari xxxxx.

Përfaqësuesi i ZPD reagoj pas deklarimit të gjyqtarit xxxxx se e njëjta Rregullore obligon kryetarin ose tash Mbikëqyrësin e Gjykatës që drejton, mbikëqyre veprimtarin, organizimin dhe aktivitetet e administratës gjyqësore të degës, ka autoritet mbi të gjithë personelin gjyqësor dhe jo gjyqësor brenda degës dhe se është e pamundur se si një kryetar të mos jetë në dijeni se çka po ndodh në gjykatë dhe kjo që tash po deklaron gjyqtari, po tregon se i njëjti ka dështuar në drejtimin e Gjykatës dhe organizimin e saj. Nuk është e mundur që një kryetar Gjykatë të mos jetë në dijeni që mbi nëntë (9) mijë lëndë të mos regjistrohet dhe kryetari të mos jetë në dijeni, po ashtu të mos jetë në dijeni që këto lëndë nuk po raportohen edhe në KGJK. Ne kemi parë që gjyqtari xxxxx i ka dërguar disa shkresa tek organet gjegjëse mirëpo nuk kemi parë se në këto shkresa i ka përmendur këtë numër enorm të lëndëve të pa regjistruara, sepse nuk është numër i vogël i lëndëve.

Me 25 korrik 2016 gjyqtari xxxxx i drejtohet kryetarit të Gjykatës Themelore në xxxxx me kërkesë për plotësimin e konkursit për pozitë referent për ekzekutime dmth problemin është në ekzekutimeve dhe me emër e mbiemër e kërkon xxxx xxxxx. Po ashtu në vitin 2016 ka bërë kërkesë për shpallje urgjente të konkursit për dy pozita në xxxxx, prapë për referent për përmbarimeve. Në të njëjtin vitë ka bërë shkresë tjetër me propozim për plotësimin e pozitës se referentit përmbarues e ku thekson se kjo gjykatë përbehet me me shumë se dymijë lëndë përmbarimore. Në këto shkresa nuk është parë që gjyqtari mbikëqyrës e ka adresua shqetësimin tij sa i përket ardhjes se lëndëve

gjegjesisht regjistrimit dhe mos regjistrimit të lëndëve, problematikes sa i përket lëndë të natyrës kundërvajtje.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroj se funksioni i gjyqtarit mbikëqyrës kërkon përgjegjësi të lart, gjyqtari mbikëqyrës duhet të shfaq përkushtim të lart në lidhje me administrimin e gjykatës. Përveç administrimi ka për obligim të mbroj edhe imazhin e drejtësisë, të demonstroj dinjitet dhe seriozitet që qytetaret kanë të drejtë ta presin nga sistemi i drejtësisë. Problemi i regjistrimit të lëndëve sipas gjyqtarit xxxx është përcjellur nga viti 2013 ne 2014, 2015, ndërsa është e pa kuptim se si nuk ka qenë i njoftuar që as një vitin 2016 nuk janë regjistruar lëndët. Gjyqtari mbikëqyrës është edhe anëtar i Komisionit Administrativ brenda Gjykatës, dhe nuk na ka treguar se ka raportua ndonjëherë këtë problem brenda këtij Komisioni, ku bën pjesë edhe kryetari i gjykatës. ZPD-ja asnjëherë nuk e ka kontestua që në atë gjykatë ka pas probleme sa i përket stafit administrativ, nuk e kemi mohua asnjëherë që këta kanë qenë komod por nga situata emergjente qysh e potencon gjyqtari xxxxx xxxxx, kërkohet dhe veprime emergjente. Prandaj në rastin konkret Komisioni i cili ka qenë i përberë nga xxxx xxxxx xxxxxx, xxxx xxxxx dhe xxxx , kanë konstatua se në vitin 2016 në këtë gjykatë nuk janë pranua 9769 qysh janë raportua zyrtarisht nga gjykatat dhe për cilën gjyqtari mbikëqyrës duhet me pas dijeni, apo është dashtë me pas dijeni, sepse është raporti zyrtar statistikor i Gjykatës për të cilën duhet të jap llogari kryetari i gjykatës dhe jo ta hedhim fajin të administratori i gjykatës. Kërkoj nga ju Komision që gjyqtari xxxxx të shpallet përgjegjës dhe të njëjtit ti shqiptohet sanksion disiplinor në përputhje me sjelljen e pahijshme të vërtetuar konform nenit 7 të Rregullores 04/2016 për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme.

Gjyqtari xxxxxx në fjalën përfundimtare deklaroj se raporti me të cilin ZPD mbështetë përgjegjësini time fare nuk ka të bëj me asnjë të vërtet. Si gjyqtar mbikëqyrës kam ndërmarr të gjitha veprimet në kuadër të veprimeve të mijja. Kam angazhuar staf mbështetës, kam angazhua dorëzues me ju ndihmuar, kohë pas kohe kam angazhua edhe pastrues me ju ndihmuar, kam angazhuar administratorin, por ka qenë e pa mundur për shkak të vëllimit të madh të lëndëve. Si gjyqtar jam marrë me ekzekutimin e sanksioneve penale, me ndihmë juridike, me problemet e stafit dhe se nuk kam pasur asnjë mundësi tjetër që të bëjë. Andaj i propozoj Komisionit që raportin mbi përgjegjësini time pasi ta analizoj me detaje të hudh në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë fakt sa i përket përgjegjësive që unë mbaj në këtë rast.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provat në shkresat e lëndës, parashtresat e dorëzuara nga ZPD-ja të cilat nuk kanë qenë të bashkangjitura në raportin përfundimtar. Pasi i shqyrtoj dhe analizoj të gjitha provat, analizoj edhe deklaratën e gjyqtarit xxxx xxxx, konstatoj se ekziston përgjegjësi e rëndë disiplinore e gjyqtarit xxxxxj. Sipas vlerësimit të Komisionit qëndron pretendimi i ZPD-së se z.xxxxx si Gjyqtar Mbikëqyrës në Degën e xxxxxx, është dashur që me një

angazhim me të madh, të kërkoj staf mbështetës ashtu siç edhe ka ndodhur në fillim të vitit 2017, ku të gjitha lëndët janë regjistruar.

Në seancën për këshillim dhe votim Komisioni njëzëri vendosi së xxxx xxxx është përgjegjës për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës. Lidhur me këtë, Komisioni në seancën për këshillim dhe votim, në mënyrë unanime i shqipton masën disiplinore **Ulje e përkohshme e rrogës për 25% në kohëzgjatje prej katër (4) muajve**, duke filluar prej muajit të ardhshëm pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Si rrethanë lehtësuesi me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, Komisioni mori parasysh numrin shumë të madh të pranimit të lëndëve kundervajtëse, mungesën se stafit për regjistrimin e tyre si dhe mos regjistrimi i këtyre lëndëve nuk pasur për pasoj parashkrimin e lëndëve pasi që këto lëndë janë regjistruar dhe dërguar tek gjyqtari kompetent, si dhe faktin se gjyqtari edhe disa muaj del në pension.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.3 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si në disipozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD-nr.14/2017, date 30.08.2017

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor;
- xxxxx xxxx , kryetare në Gjykatën Themelore në xxxxxx;
- xxxxx xxxx, Gjyqtar Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në xxxxx-dega në xxxxx;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;